



BULETIN

3– MUJOR/NR.
TETOR – DHJETOR 2006
PASQYRA E TITUVJE
KRYESORË :

1. RESPEKTIMI I TE DREJTAVE TE QYTETAREVE
2. OFRIM EKSPERTIZE NE RUSHEN E LEGJISLACIONIT DHE P RAKTIKES
 - OPOENCA LIGJORE
 - OFRIM EKSPERTIZE
3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE PER ADMINISTRATEN E BURGJEVE
4. TAKIME PUNE ME PERFAQESUES TE INSTITUCIONEVE TE NDRYSHME SHETERORE
5. RRRITJA E NDERGJEGJESIMIT DHE E EDUKIMIT TE PUBLIKUT
 - VEPRIMTARI NDERGJEGJESUESE DHE EDUKUESE
 - FUSHATA NDERGJEGJESUESE
 - BOTIME TE KSHH-SE
 - TRYEZA TE RRUMBULLAKETA
6. KESHILLIME LIGJORE
7. RASTE TE VERIFIKUARA NGA KSHH-JA
8. REAGIME PUBLIKE TE KSHH-SE
9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHETERORE
10. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATES
 - PLANI STRATEGJIK DHE BIZNESPLANI I KSHH-SE 2007-2010
 - NGRITJE E KAPACITETEVE TE KSHH-SE
11. PJESEMARRJE NE AKTIVITETE TE NDRYSHME

Përgatiti buletin: av. *Klesta Alikaj*
Juriste/Koordinatorë projekti
Redaktimi letrar: *Marie Mato*

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

Nr.

TETOR – DHJETOR 2006

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID-it (CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT)

Oponenca ligjore për Planin e strategjisë së Policisë së Shtetit (plan 10-vjeçar)

Në kuadër të përgatitjes së strategjisë sektorale “Për rendin publik”, gjatë muajit dhjetor 2006, KShH-ja u angazhua për të dhënë opinionin e vet për Planin e strategjisë së Policisë së Shtetit (plan 10 – vjeçar). Dhënia e këtij opinionin synonte përsosjen e këtij plani me qëllim që të përmirësohen rendi publik, marrëdhëniet e policisë me publikun dhe respektimi i të drejtave të njeriut nga policia gjatë përbushjes së detyrave dhe funksioneve të saj.

Vazhdon në faqen 3

Fushata e përbashkët “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes aktorëve të shoqërisë civile kundër diskriminimit, Këshilli i Europës ka marrë iniciativën e realizimit të fushatës antidiskriminim nën moton: “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”. Në kuadër të fushatës është krijuar Komiteti Kombëtar i Fushatës “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”, në të cilin bëjnë pjesë Këshilli i Europës, Ministria e Turizmit, e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Aleanca për të Drejtat e Fëmijëve, Këshilli Rinor Shqiptar dhe Parlamenti Rinor. Fushata ka filluar në qershor 2006 dhe përfundon në qershor 2007. Fushata ka në qendër të saj *diversitetin, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen*.

Vazhdon në faqen 9

Tryezë e rumbullakët për mundësinë e realizimit të punësimit të të dënuarve

Në datat 30 nëntor-1 dhjetor 2006, KShH-ja organizoi një tryezë të rumbullakët për gjetjen e strategjive të duhura për punësimin e të dënuarve në burgje dhe për përcaktimin e formave të ndryshme të punësimit të të dënuarve sipas të kushteve të veçanta të secilit burg¹.

Pjesëmarrësit theksuan se faktori kryesor për realizimin e punësimit të të dënuarve në burgje është përmirësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë. Ekspertët e huaj dhanë shembuj nga praktika e mirë e disa vendeve të Europës¹ duke theksuar nevojën e përshtatjes së tyre me kushtet dhe veçoritë e sistemit vendës.

Vazhdon në faqen 11

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr: Gjin Bue Shpata; pall. 5/1,
ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
web-site: www.ahc.org.al

Tel: 04 233671
Cel: 068 20 23699;
E-mail: office@ahc.org.al

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

1.1 Respektimi i të drejtave të personave të vendosur në vendet e paraburgimit

Monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur ka qenë në vëmendje të KShH-së edhe gjatë muajve tetor-dhjetor 2006. Në përfundim të vëzhgimit të rreth 15 institucioneve të paraburgimit, KShH-ja evidentoi një sërë problemesh dhe shkeljesh të të drejtave të të paraburgosurve. Për këtë, së shpejti do të publikojë një raport të veçantë i cili, përveç problemeve të konstatuara, do të përmbajë edhe rekomandime për përmirësimin e situatës në këto institucione¹.

1.2 Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës në sistemin e drejtësisë penale - në fokusin e KSHH-së²

Për të dhënë ndihmesën e vet në respektimin më të mirë të të drejtave të fëmijëve në kontakt me drejtësinë penale, KShH-ja ka studiuar dosjet dhe vendimet penale të formës së prerë për të miturit, të dhëna gjatë vitit 2005, si dhe një pjesë të vendimeve të dhëna gjatë vitit 2006. Studimi u krye në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, gjatë periudhës shtator – nëntor 2006. Për kryerjen e studimit u angazhuan 7 ekspertë lokalë dhe 4 studentë të Fakultetit të Drejtësisë.

Objekt vëzhgimi ishin masat e sigurimit dhe vlerësimi i tyre, respektimi i të drejtave procedurale në seancat gjyqësore me të mitur, realizimi i mbrojtjes psikologjike dhe juridike, zbatimi i masave të dënimit dhe i alternativave të tij etj. Gjetjet e studimit u paraqiten në një tryezë me aktorë të ndryshëm³. Përfundimet e këtij studimi u bënë publike për grupet e interesuara dhe median.

1.3 Monitorimi i proceseve penale për të miturit⁴

Krahas studimit të vendimeve gjyqësore, për periudhën tetor–nëntor 2006 u monitoruan proceset gjyqësore me të pandehur të mitur, kryesisht në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Në këto vëzhgime u angazhuan 4 studentë të Fakultetit të Drejtësisë. Të dhënat e mbedhura nga vëzhgimi u paraqitën në një tryezë me aktorë të ndryshëm shtetërorë dhe të shoqërisë civile, përfshirë edhe punonjës të sistemit të drejtësisë penale.

1.4 Respektimi i të drejtave të emigrantëve shqiptarë vazhdon të jetë në vëmendje të KSHH-së

Edhe gjatë kësaj periudhe, KShH-ja ka monitoruar respektimin e të drejtave të emigrantëve të parregullt dhe të rregullt nga policia kufitare dhe e migracionit. Në datat 16-18 nëntor 2006 u kryen monitorime në pikën kufitare të Morinës në Kukës dhe u zhvilluan takime me përfaqësues të drejtorisë së policisë të qarkut Kukës. Gjithashtu, duke mbajtur parasysh fluksin në rritje të lëvizjes së emigrantëve shqiptarë nga vendet fqinje, në datat 20-23 dhjetor 2006 u organizua një tur vëzhgimi në tri pikat kryesore të kalimit kufitar me Greqinë, përkatësisht në pikat e kalimit kufitar: Kapshticë (Korçë), Tri Urat (Përmet) dhe Kakavijë (Gjirokastrë). Qëllimi i vëzhgimeve

¹ Vëzhgimet janë realizuar në kuadër të projektit “Drejtimi i institucioneve të paraburgimit sipas këndvështrimit të të drejtave të njeriut”, i mbështetur financiarisht nga Fondi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, pranë Departamentit të Shtetit të ShBA-së.

² Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i.

³ Për më shumë, shih më poshtë: “Tryeza të rumbullakëta”.

⁴ Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i.

ishte vlerësimi i situatës në këto pika kufitare dhe respektimi i të drejtave të emigrantëve⁵. Vëzhguesit konstatuan përmirësime të infrastrukturës në këto pika kufitare, por ende mbetet për të bërë lidhur me plotësimin me staf femër dhe kualifikimin e stafit për trajtimin e femrave dhe të fëmijëve⁶.

2. OFRIM EKSPERTIZE NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT DHE TË ZBATIMIT TË TIJ

2.1 Oponenca ligjore

2.1.1 Oponenca ligjore për Planin e strategjisë së Policisë së Shtetit (plan 10-vjeçar)

Në kuadër të përgatitjes së strategjisë sektorale “Për rendin publik”, gjatë muajit dhjetor 2006, KShH-ja u angazhua në dhënien e opinionit të vet për Planin e strategjisë së Policisë së Shtetit (plan 10-vjeçar). Dhënia e këtij opinionit synon përsosjen e këtij plani me qëllim që të përmirësohen rendi publik, marrëdhëniet e policisë me publikun dhe respektimi i të drejtave të njeriut nga policia gjatë përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të saj.

2.1.2 Oponenca ligjore për projektligjin “Për Policinë e Shtetit”

Me qëllim përmirësimin e respektimit të të drejtave të shtetasve nga policia dhe shmangien e mangësive ligjore që mund të çojnë në shkeljen e të drejtave gjatë ushtrimit të funksioneve nga policia, KShH-ja dhe organizata të tjera të shoqërisë civile paraqitën opinionet e tyre lidhur me përputhshmërinë e projektligjit “Për Policinë e Shtetit” me standardet e të drejtave të njeriut. Sipas KShH-së, projekti përmbante dispozita të paqarta dhe rregullime që mundësonin cenimin e lirive dhe të të drejtave të shtetasve nga policia.

Falë ndërhyrjes së aktorëve të ndryshëm, projekti iu kthye grupit të punës për të reflektuar shqetësimet e ngritura.

2.2 Ofrim ekspertize

2.2.1 Takim lidhur me nevojën e një ligji për fetë

Në datën 1 nëntor 2006, Komiteti Shtetëror për Kultet organizoi një takim në nivel ekspertësh, me Ministrinë e Turizmit, Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi në rrethe specialistësh për nevojën e një ligji për fetë në Republikën e Shqipërisë. Të pranishëm në takim ishin përfaqësues të institucioneve shtetërore, specialistë të fushës, të angazhuar në dhënien e ekspertizës për hartimin e projekt marrëveshjes midis shtetit shqiptar dhe bashkësive fetare në Shqipëri, përfaqësues akademikë dhe të organizatave jofitimprurëse, mes tyre edhe nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Pjesëmarrësit e këtij takimi dhanë dhe shkëmbyen mendime të ndryshme për nevojën e hartimit të një ligji për bashkësitë fetare që veprojnë në Shqipëri. Edhe KShH-ja mendon se ligji për fetë është i nevojshëm.

2.2.2 Ofrim i ekspertizës në kuadër të hartimit të strategjisë kombëtare kundër dhunës në familje

⁵ Vëzhgimet u realizuan në kuadër të projektit “Për monitorimin e respektimit të të drejtave të emigrantëve dhe të personave të kthyer”

⁶ Për më shumë informacion lidhur me përfundimet e dala nga vëzhgimet, lutemi të vizitoni adresën <http://ahc.org.al/kshh/ARKIV/2007/10raport.htm> <http://ahc.org.al/kshh/ARKIV/1212raport.htm>

Në kuadër të hartimit të strategjisë kombëtare kundër dhunës në familje, nismë kjo e Ministrisë së Punëve, e Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta dhe Qendrës Gjimore për Zhvillim, u ngrit një grup pune, ku bën pjesë edhe KShH-ja. Ai ofroi ekspertizën e tij lidhur me respektimin e të drejtave të grave dhe të vajzave të dënuara me burgim.

Për prezantimin e strategjisë dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje, në datën 25 nëntor 2006 u organizua një tryezë e rumbullakët në të cilën mori pjesë edhe KShH-ja.

2.2.3 Informacion për pjesëmarrjen në workshop-Maqedoni

Gjatë periudhës 24-25 nëntor 2006, Friedrich Ebert Stiftung, në Shkup, në bashkëpunim me European Center for Minority Issues, organizuan një workshop rajonal për monitorimin dhe përmirësimin e të drejtave të minoriteteve. Duke qenë se gjatë vitit 2006 KShH-ja zbatoi projektin "Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në Bashkinë e Korçës", përfaqësues të tij, së bashku me përfaqësues nga Bashkia e Korçës⁷, morën pjesë në këtë aktivitet i cili synonte vazhdimësinë e punës në fushën e minoriteteve edhe për vitin 2007. Disa nga çështjet kryesore të diskutuara në workshop ishin: a) administrata publike-përgjegjësia, përfshirja dhe ndërgjegjësimi; b) roli i strukturave ndëretnike të institucionalizuara; c) vëzhgimi i të drejtave të minoriteteve. Të pranishëm në workshop ishin përfaqësues të sektorit akademik, OJF-ve nga shtete të ndryshme të rajonit dhe përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore.

2.2.4 Forumi lidhur me pjesëmarrjen e minoriteteve në vendimmarrje

Në datën 4 dhjetor 2006, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve organizoi një forum, qëllimi i të cilit ishte diskutimi i pjesëmarrjes së minoriteteve në politikë dhe në politikëbërje. Të ftuar në këtë forum ishin përfaqësues të organizatave kryesore minoritare që veprojnë në Shqipëri, përfaqësues të partive politike, të organizatave jofitimprurëse etj. Në forum referuan dhe shprehën mendime për pjesëmarrjen e minoriteteve në jetën publike, vendimmarrje dhe politikëbërje përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit që kanë përvojë të gjatë në fushën e minoriteteve, sidomos në monitorimin dhe dhënien e rekomandimeve për respektimin e të drejtave të minoriteteve⁸.

2.2.5 Pjesëmarrje në koalicionin e OJF-ve për raportet alternative

Në muajin shtator 2006, KShH-ja u bë pjesë e koalicionit të OJF-ve për hartimin e raporteve alternative. Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006 janë organizuar disa takime koordinuese të koalicionit dhe u ngrit grupi i punës për hartimin e raportit alternativ për konventën "Për eliminimin e diskriminimit ndaj grave". Për hartimin e këtij raporti, KShH-ja ofroi ekspertizën e vet në fushën ligjore dhe atë të minoriteteve.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, koalicioni publikoi draftin e parë të raportit alternativ dhe doli me një deklaratë për shtyp.

2.2.6 Zgjedhjet vendore 2007 dhe reforma ligjore për arritjen e standardeve - në fokusin e KSHH-së

⁷ Në kuadër të projektit "Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në Bashkinë e Korçës", KShH-ja ka pasur bashkëpunim të ngushtë me bashkinë dhe këshillin bashkiak të Korçës.

⁸ Gjatë vitit 2006, KShH-ja monitoroi marrëdhëniet e minoriteteve me organet e qeverisjes vendore në bashkinë e Korçës. Projekti u mundësua financiarisht nga Friedrich Ebert Stiftung.

Në kuadër të monitorimit dhe të koordinimit të punës për zgjedhjet vendore 2007, me ftesë të delagacionit të OSBE/ ODIHR-it, gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006, KShH-ja zhvilloi dy takime me përfaqësues të këtij organizimi. Në këto takime, përfaqësues të KShH-së shprehën opinionet e tyre për situatën parazgjedhore, për reformën zgjedhore dhe për përgatitjen për zgjedhjet vendore. KShH-ja ndau shqetësimin për situatën e rënduar politike dhe për mungesën e konsensusit mes forcave politike të cilat cenojnë rëndë të drejtat e votuesve dhe mund të cenojnë standardet e zgjedhjeve.

3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE PËR ADMINISTRATËN E BURGJEVE

3.1 Sesioni i parë trajnues i stafit të nivelit bazë të institucionit të paraburgimit në Lezhë

Në datat 2-3 tetor 2006, në mjediset e institucionit të paraburgimit në Lezhë, KShH-ja organizoi sesionin e parë trajnues për stafin me uniformë të nivelit bazë të regjimit të brendshëm⁹. Objektivat kryesorë të kësaj veprimtarie ishin: rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të nivelit bazë në procesin e mirëmenaxhimit, ndihmesa në zbatimin më të mirë të standardeve ndërkombëtare dhe të rregullores së burgut, si edhe përmirësimi i komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm me qëllim realizimin e programit ditor të aktiviteteve. Çështje të trajtuara ishin: misioni, vizioni i përgjithshëm i sistemit të paraburgimit, disa aspekte të mirëmenaxhimit të institucioneve të paraburgimit si edhe roli i stafit me uniformë të nivelit bazë në këtë proces. Si çështje për trajtim, pjesëmarrësit dhe ekspertët përzgjedhën aspektet konkrete të mirëmenaxhimit të institucioneve të paraburgimit duke synuar respektimin më të mirë të të drejtave të të paraburgosurve dhe menaxhimin më të mirë të këtyre institucioneve¹⁰. Në këtë trajnim ofruan ekspertizën e tyre ekspertët holandezë z. Jan van den Brand dhe z. Cees Boeij, drejtorë të Përgjithshëm në sistemin e burgjeve holandeze.

3.2 Sesioni i dytë trajnues i stafit të nivelit bazë të institucionit të paraburgimit në Lezhë

Në datat 9-10 nëntor 2006, në mjediset e institucionit të paraburgimit në Lezhë, KShH-ja organizoi sesionin e dytë trajnues për stafin me uniformë të nivelit bazë të regjimit të brendshëm¹¹. Objektivat kryesorë të sesionit trajnues ishin: ndihmesa për zbatimin më të mirë të standardeve ndërkombëtare dhe të rregullores së burgut; pajisja e stafit me uniformë me një koncept të drejtë të sigurisë dinamike për krijimin e një atmosfere të sigurt brenda institucionit dhe ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet sigurisë, drejtësisë dhe kontrollit si edhe menaxhimi më i mirë i situatave të vështira në një institucion paraburgimi. Në këtë trajnim ofruan ekspertizën e tyre ekspertët holandezë me përvojë të gjatë, përkatësisht z. Jan van den Brand dhe z. Cees Boeij¹².

⁹ Ky aktivitet është pjesë e një raundi trajnimesh që KShH-ja do të realizojë me administratën e institucionit të paraburgimit në Lezhë gjatë vitit 2006-2007. Qëllimi kryesor është të kontribuojë në procesin e shndërrimit të institucionit të paraburgimit në Lezhë në një model të mirëmenaxhimit të sistemit të paraburgimit.

¹⁰ Ky sesion pune është realizuar në kuadër të projektit të KShH-së "Drejtimi i institucioneve të paraburgimit sipas këndvështrimit të të drejtave të njeriut", i mbështetur financiarisht nga Fondi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, pranë Departamentit të Shtetit të ShBA-së.

¹¹ Ky sesion pune është realizuar në kuadër të projektit të KShH-së "Drejtimi i institucioneve të paraburgimit sipas këndvështrimit të të drejtave të njeriut", i mbështetur financiarisht nga Fondi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, pranë Departamentit të Shtetit të ShBA-së.

¹² Drejtorë të Përgjithshëm në sistemin e burgjeve holandeze.

Bazuar në diskutimet e vetë pjesëmarrësve dhe në trajtimin e rasteve konkrete nga praktika, KShH-ja dhe ekspertët hartuan dhe paraqitën rekomandime për zgjidhjen e situatave të ndryshme në institucionet e paraburgimit¹³. Pjesëmarrësit e vlerësuan dobishmërinë dhe trajtimin konkret të problemeve.

Pjesëmarrës në trajtim ishin rreth 40 punonjës të këtij institucioni.

4. ADRESIMI I PROBLEMEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHITETËRORE DHE TE AKTORËT E TJERË NË FUSHË

4.1 Takim me ministrin e Drejtësisë dhe drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve

Në datën 4 dhjetor 2006, përfaqësues të KShH-së dhe z. Jan van den Brand, ekspert holandez për çështjet penitenciare, ekspert i KShH-së, morën takim me z. Aldo Bumçi, ministër i Drejtësisë dhe z. Saimir Shehri, drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve.

Takimi u organizua në kuadër të këshillimeve që KShH-ja u ofron autoriteteve përkatëse për çështje të ndryshme me interes. Çështje të trajtuara në takim ishin: lejet për të dënuarit, masat ndëshkimore të marra ndaj personelit në burgje në raste incidentesh etj., si dhe disa probleme të diskutuara gjatë sesionit të punës për punësimin e të dënuarve në burgje.

Pjesëmarrësit në takim ishin të mendimit se është i nevojshëm organizimi i një tryeze ekspertësh për të diskutuar njësimin e politikës së dhënies së lejeve për të dënuarit. U mirëpritën edhe rekomandimet e KShH-së dhe të ekspertit të tij se të gjitha rastet e incidenteve duhet të vijojnë me një analizë e cila do të ndihmonte në parandalimin e situatave të ngjashme dhe se, nëse ato ndodhin, duhen marrë masat e duhura për menaxhimin e tyre.

4.2 Takim i Nënkomitetit për Reformën në Burgje, organizuar nga të Konsorciumi Ndërkombëtar

Në datën 5 dhjetor 2006, KShH-ja mori pjesë në takimin e Nënkomitetit për Reformën në Burgje i organizuar nga Konsorciumi Ndërkombëtar, pjesë e të cilit është edhe KShH-ja. Pjesëmarrësit u përqendruan në situatën aktuale në sistemin e paraburgimit dhe problematikën që lidhet me të. KShH-ja trajtoi problemet që shqetësojnë sistemin e paraburgimit në vend, bazuar nga të dhënat e dala në vëzhgimin e kryer nga ky komitet në 13 vende paraburgimi. Takimi doli me rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës në dhomat e paraburgimit në vend, të cilat do t'u bëhen të njohura autoriteteve përkatëse. Gjithashtu, pjesëmarrësit dolën me rekomandime konkrete që do të paraqiten në takimin plenar të Konsorciumit Ndërkombëtar, të datës 8 shkurt 2007.

4.3 Vendosja e kontakteve të drejtpërdrejta të KSHH-së me përfaqësues të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe aktorë të tjerë që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Më qëllim njohjen më të mirë të gjendjes së respektimit të të drejtave të miturve, zgjerimin e veprimtarive të KShH-së në nivel vendor, rritjen e shkallës së informimit dhe të sensibilizimit të të miturve për të drejtat dhe mekanizmat e ushtrimit të tyre si dhe për koordinimin e veprimtarive mes aktorëve të ndryshëm, stafi i KShH-së, korrespondentët dhe ekspertët e përzgjedhur të tij morën takime me përfaqësues të institucioneve të pushtetit në nivel

¹³ Rekomandimet iu bënë të njohura edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

vendor dhe qendror, OJF-ve dhe institucioneve arsimore. Takime të tilla u zhvilluan në rrethet Tiranë, Shkodër, Fier, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë dhe Vlorë¹⁴.

Korrespondentët e KShH-së vunë theksin te nevoja e marrjes së masave për përmirësimin e situatës së të drejtave të fëmijëve. Aktivitetet sensibilizuese të KShH-së u mirëpritën dhe u vlerësuan të dobishme nga drejtoritë arsimore dhe drejtuesit e shkollave që morën pjesë në veprimtaritë.

Duke vlerësuar rolin e medias në sensibilizimin e publikut, korrespondentët e KShH-së morën takime me përfaqësues të mediave lokale, të OJF-ve lokale në rrethet Korçë, Fier, Gjirokastrë dhe Vlorë.

Krahas veprimtarive të mësipërme, KShH-ja ka marrë pjesë në takime dhe koalicione për respektimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe në një sërë aktivitete të përbashkëta me organizata të tjera të të drejtave të njeriut, si CRCA, ILO/IPEK, Klinika Ligjore për të Miturit, Këshilli i Europës, Alb Child Net dhe institucione shtetërore, si: Avokati i Popullit, nënseksioni për të miturit, Nënkomisioni parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve etj.

5. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E EDUKIMIT TË PUBLIKUT

5.1 VEPRIMTARI NDËRGJEGJËSUESE DHE EDUKUESE

5.1.1 Forcimi i rolit lobues të shoqërisë civile për parandalimin e dukurisë së punësimit të paligjshëm të fëmijëve

Në datën 20 tetor 2006, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri organizoi një takim koordinues për forcimin e rolit lobues të shoqërisë civile për parandalimin e dukurisë së punësimit të paligjshëm të fëmijëve. Pjesë e këtij takimi ishte dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Në përfundim të takimit u krijua një grup pune me përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët do të ndërmarrin nisma konkrete për parandalimin e dukurisë së punësimit dhe të trafikimit të fëmijëve. Objektivat kryesorë të këtij grupi janë: rishikimi dhe studimi i legjislacionit në fushën e punësimit dhe të trafikimit të fëmijëve, gjetja e mangësive dhe e boshllëqeve ligjore që favorizojnë këto dukuri të kundërligjshme si edhe realizimi i një seance dëgjimore në Parlament lidhur me këto çështje me qëllim rritjen e shkallës së sensibilizimit të klasës politike.

5.1.2 Seanca dëgjimore për projektligjin “Për Policinë e Shtetit” në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë

Më 6 dhjetor 2006, KShH-ja dhe disa organizata të të drejtave të njeriut patën një seancë dëgjimore në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me projektligjin “Për Policinë e Shtetit”. Në këtë seancë u paraqitën opinionet e organizatave lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut që mundësonte miratimi i këtij projektligji, në formën e paraqitur për diskutim.

Pjesëmarrës në këtë seancë ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, të Policisë së Shtetit dhe të organizatave ndërkombëtare që asistojnë Policinë e Shtetit.

Seanca dëgjimore u vlerësua jo vetëm për dobishmërinë e saj në përmirësimin e projektligjit, por edhe për rolin aktiv mbrojtës dhe lobues të organizatave të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe KShH-ja në Shqipëri.

5.1.3 KSHH-ja inkurajon vlerat dhe aftësitë e të paraburgosurve dhe të dënuarve

¹⁴ Veprimtari të tilla janë kryer në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, më 12 dhjetor 2006, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve organizoi një aktivitet me temë “Ekspoze vlerash njerëzore”. Aktiviteti synonte të inkurajonte përpjekjet pozitive të të paraburgosurve dhe të dënuarve për integrimin e tyre në shoqëri. Në aktivitet u ekspozuan punimet më të mira të të dënuarve në fusha të ndryshme, si p.sh.: punime artizanale, punime me dorë, pikturë dhe poezi.

KShH-ja dha ndihmesën e vet duke ofruar çmime simbolike, shoqëruar me certifikata, për 4 krijimet më të mira në pikturë, në poezi, në punimin me dorë dhe atë artizanal, të realizuara nga të paraburgosur dhe të dënuar të ndryshëm dhe duke theksuar mesazhin se riintegrimi i të dënuarve fillon që në kontaktet e tyre të para me institucionet e vuajtjes së dënimit.

Në këtë veprimtari, KShH-ja tërhoqi vëmendjen e autoriteteve përkatëse shtetërore për përsheptimin e procesit të rishikimit të aktit nënligjor që do të rregullojë punësimin e të dënuarve në burgje dhe shpërblimin e punës së tyre.

5.1.4 Aktivitete lobuese me Nënkomisionin parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve

Më 21 nëntor 2006, me nismën e Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve (CRCA), disa organizata jofitimprurëse, përfshirë edhe KSHH-në, organizuan një seancë të hapur dëgjimore me Nënkomisionin parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve. Seanca u organizua me rastin e përvjetorit të konventës “Për të drejtat e fëmijëve”.

Problemet e adresuara nga OJF-të pjesëmarrëse kishin të bënin me: punësimin e fëmijëve, fëmijët endacakë, dhunën e ushtruar ndaj tyre, fëmijët në konflikt me ligjin, arsimimin e tyre etj. Përfaqësuesja e KShH-së, E. Saliu, u përqendrua në problemet e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe në nevojën e mbështetjes së nismave në drejtim të reformës së drejtësisë për të miturit. KShH-ja paraqiti rekomandime konkrete për strukturat ligjvënëse dhe politikëbërëse në Shqipëri.

5.1.5 Të miturit mund të japin ndihmesën e tyre në respektimin më të mirë të të drejtave të veta¹⁵

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve dhe të përvjetorit të konventës “Për të drejtat e fëmijëve” (më 20 nëntor 2006), Komiteti Shqiptar i Helsinkit zhvilloi tri seminare me nxënës të shkollave të mesme dhe tetëvjeçare në rrethet Korçë, Fier dhe Vlorë. Qëllimi i tyre ishte informimi dhe ndërgjegjësimi më i mirë e të miturve për të drejtat e tyre dhe nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve në nisma të përbashkëta për respektimin e të drejtave të tyre në të gjithat mjediset ku ata jetojnë dhe mësojnë. Ekspertët e ftuar në seminare¹⁶ trajtuan të drejtat e fëmijëve sipas legjislacionit shqiptar: të drejtat e të miturit- autor i veprave penale, të drejtat e të miturit- viktimë e një krimi dhe të drejtat e të miturit- dëshmitar në një vepër penale. Interes i veçantë u tregua për çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e të rinjve nga policia, me dhunën ndaj fëmijëve në familje dhe në shkollë.

Veprimtaritë e mësipërme shërbyen edhe si një mundësi për të paraqitur përfundimet kryesore të dala nga studimi i vendimeve gjyësore ndaj të miturve, të dhëna nga gjykatat në rrethin përkatës gjatë vitit 2005 dhe gjysmës së 2006-s.

Në seminare morën pjesë nxënës të shkollave të mesme dhe tetëvjeçare, mësues dhe përfaqësues vendorë të shoqërisë civile të këtyre rretheve, të Parlamentit Rinor, korrespondentët sipas rrethit, ekspertët e ftuar dhe përfaqësues nga stafi i KShH-së. Seminaret u vlerësuan si nga të rinjtë, ashtu edhe nga mësuesit dhe pjesëmarrësit e tjerë.

¹⁵ Kjo veprimtari u realizua në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i.

¹⁶ Komiteti Shqiptar i Helsinkit falënderon znj. Vezire Dushi, znj. Nereida Binaj dhe z. Artur Brahimllari si dhe korrespondentet e KShH-së në rrethet Fier, Korçë dhe Vlorë për ndihmesën e dhënë në realizimin e këtyre veprimtarive.

Gjithashtu, KShH-ja u dhuroi bibliotekave të shkollave: “Jani Minga” në Vlorë, “Flatrat e dijes” në Fier dhe “Tefta Tashko” në Korçë nga një set me publikime në fushën e të drejtave të fëmijëve¹⁷.

5.1.6 Veprimtari sensibilizuese me studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Fakultetit të Drejtësisë¹⁸

Në datat **13 – 15 dhjetor 2006**, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut (10 dhjetor 2006), në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe atë të Drejtësisë, KShH-ja organizoi një panair 3-ditor me publikimet e KShH-së ndër vite. Kjo veprimtari synoi jo vetëm sensibilizimin dhe rritjen e njohurive të studentëve për të drejtat e njeriut, por edhe forcimin e bashkëpunimit mes organizatave të të drejtave të njeriut, të të rinjve dhe institucioneve universitare. Studentët-vullnetarë të KShH-së pranë Fakultetit të Drejtësisë dhe Fakultetit të Shkencave Sociale¹⁹ u morën me mbarëvajtjen e panairit.

5.2 FUSHATA NDËRGJEGJËSUESE

5.2.1 Fushata e përbashkët “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”²⁰

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes aktorëve të shoqërisë civile kundër diskriminimit, Këshilli i Europës ka marrë nismën e realizimit të fushatës antidiskriminim nën moton: “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”. Në kuadër të fushatës është krijuar Komiteti Kombëtar i Fushatës “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”, ku bëjnë pjesë: Këshilli i Europës, Ministria e Turizmit, e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Aleanca për të Drejtat e Fëmijëve, Këshilli Rinor Shqiptar dhe Parlamenti Rinor. Fushata ka filluar në qershor 2006 dhe përfundon në qershor 2007. Fushata ka në qendër të saj diversitetin, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen.

Në 27 tetor 2006, në kuadër të kësaj fushate, në sheshin “Nënë Tereza” u organizua festivali “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë” në të cilin organizatat, anëtarë të këtij komiteti, dhanë mesazhe për mosdiskriminim. Më pas u dha një koncert festiv. Në këtë aktivitet morën pjesë: Ministria e Turizmit, e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve, Këshilli i Europës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Aleanca për të Drejtat e Fëmijëve dhe Këshilli Rinor Shqiptar.

Në kuadër të këtij aktiviteti, u përgatitën postera dhe bluza me logot dhe me sloganin “Të gjithë të ndryshëm, të gjithë të barabartë”. Mesazhi i KShH-së iu kushtua minoriteteve, kryesisht atyre rom dhe egjiptian²¹.

5.2.2 Fushata ndërgjegjësuere për Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve, 20 nëntor 2006, KShH-ja **organizoi tri seminare me nxënës** të shkollave të mesme dhe tetëvjeçare të rretheve Fier, Vlorë

¹⁷ Shih në shtojcën nr. 5, programin e seminareve, foto te aktivitetit dhe listëprezencën e fotokopjuar.

¹⁸ Kjo veprimtari u realizua në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i.

¹⁹ Falënderojmë studentët që u angazhuan për zhvillimin e këtij aktiviteti: Florian Trojani, Klesta Hysi, Lindita Kaba dhe Jonida Mete (studentë të Fakultetit të Drejtësisë) dhe Irismilda Gjonaj, Gentian Tushilla, Blerina Rropi dhe Lirjeta Mustafaj (studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale). Falënderime të veçanta u adresojmë dekanateve të fakulteteve për mbështetjen e këtyre veprimtarive.

²⁰ Kjo fushatë u zhvillua në kuadër të projektit “Ngritje kapacitetesh dhe zhvillimi i organizatës”, mbështetur financiarisht nga CORDAID-i

²¹ Veprimtari të tjera janë planifikuar të zhvillohen gjatë muajit mars 2007.

dhe Korçë, pjesë e të cilave ishte edhe sensibilizimi i të rinjve për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre. Në kuadër të kësaj dite, me nismën e CRCA-së, më 21 nëntor 2006, u mbajt një seancë dëgjimore për të drejtat e fëmijëve në Nënkomisionin parlamentar për të Drejtat e Fëmijëve dhe Komisionin e Shëndetësisë. Në këtë seancë dëgjimore në Kuvend KShH-ja paraqiti problematikën e sistemit të drejtësisë penale për të miturit, ndërsa organizatat e tjera trajtuan probleme të punësimit të fëmijëve, të abuzimit me ta, të mungesës së shërbimeve etj.

5.2.3 Fushata ndërgjegjësuere për Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut²²

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 2006, KShH-ja ndërmori një sërë aktivitete, tri emisione në radiot lokale të rretheve Korçë, Fier dhe Gjirokastrë si dhe u botuan dy shkrime në gazetën lokale të rretheve Vlorë dhe Tiranë. Në këto emisione dhe shkrime u prezantuan përfundimet e studimit të sistemit të drejtësisë së të miturve në rrethet përkatëse, si dhe u bënë publike disa sugjerime për të respektuar më mirë të drejtat e fëmijës në procesin penal.

5.2.4 Fushata ndërgjegjësuere për Ditën Botërore kundër Abuzimit të Fëmijëve

Në datën 17 dhjetor 2006, në kuadër të Ditës Botërore kundër Abuzimit të Fëmijëve, me nismën e CRCA-së, shumë organizata dolën me një deklaratë të përbashkët drejtuar qeverisë dhe Kuvendit, me mesazhin e përbashkët: “Një botë pa dhunë për fëmijët”. Në këtë deklaratë i kërkuan qeverisë shqiptare: të merrte masa për miratimin e një ligji kundër dhunës së fëmijëve, të merrte masa për përmirësimin e niveleve të shërbimeve për fëmijët - viktime të dhunës, si dhe ta vendoste si përparësi të saj çështjen e fëmijëve dhe marrjen e masave.

5.3 BOTIMET E KSHH-SË

5.3.1 KSHH-ja më pranë publikut

Për të qenë më pranë qytetarëve, për vitin 2007, KShH-ja përgatiti 2 lloje kalendarësh me mesazhe për të drejtat e qytetarëve dhe adresimin e tyre te KShH-ja në rast se u shkelen të drejtat nga organet e policisë, nga administrata në burgje ose nga administrata publike.

5.3.2 Publikimi i përfundimeve kryesore për respektimin e të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës

Përfundimet kryesore të dala nga vëzhgimi i të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës, u paraqitën në tryezën e rrumbullakët të organizuar në qytetin e Korçës, më 15 nëntor 2006²³. Përveç publikimit të tyre në faqen e internetit të KSHH-së²⁴, së shpejti do të botohet studimi i plotë, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse²⁵.

5.4 TRYEZA TË RRUMBULLAKËTA

²² Këto aktivitete u zhvilluan në kuadër të projektit “Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës”, mbështetur financiarisht nga CORDAID-i dhe fondacioni SOROS.

²³ Për më shumë, shih kapitullin “Tryeza të rrumbullakëta”.

²⁴ Për më shumë, shih: http://ahc.org.al/kshh/ARKIV/studimi_minoritetet.pdf

²⁵ Studimi u realizua në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”, mbështetur financiarisht nga Friedrich Ebert Stiftung.

5.4.1 Tryezë e rrumbullakët për minoritetet

Më 15 nëntor 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një tryezë të rrumbullakët në qytetin e Korçës me qëllim prezantimin e përfundimeve kryesore të dala nga anketimi i qytetarëve dhe i administratës bashkiake të Korçës për respektimin e të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës.

Të pranishëm ishin 50 pjesëmarrës, përfaqësues të këshillit bashkiak të Korçës, përfaqësues të administratës së bashkisë së Korçës, të shoqërisë civile, përfaqësues të minoriteteve në Korçë, si dhe të disa organizatave që përfaqësojnë minoritetet ose që punojnë me minoritetet, me seli në Tiranë. Të pranishmit vlerësuan raportin, si hapin e parë në punën e bashkisë së Korçës për një respektim më të mirë të të drejtave të minoriteteve në këtë qytet.

Pas përfundimit të tryezës së rrumbullakët, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, z. Gjergji Sinani, eksperti i angazhuar në studimin e KShH-së dhe z. Gjergji Mero, kryetar i këshillit bashkiak të Korçës ishin të ftuar në një emision televiziv ku diskutuan për studimin e realizuar, përfundimet kryesore të dala prej tij dhe angazhimin në të ardhmen të kësaj bashkie për respektimin e të drejtave të minoriteteve.

5.4.2 Tryezë e rrumbullakët për mundësinë e realizimit të punësimit të të dënuarve

Në datat 30 nëntor-1 dhjetor 2006, KShH-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët për gjetjen e strategjive të duhura për punësimin e të dënuarve në burgje dhe përcaktimin e formave të ndryshme të punësimit të të dënuarve sipas të kushteve të veçanta të secilit burg ²⁶.

Pjesëmarrësit theksuan se faktori kryesor për realizimin e punësimit të të dënuarve në burgje ishte përmirësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë. Ekspertët e huaj dhanë shembuj nga praktika e mirë e disa vendeve të Europës²⁷ duke theksuar nevojën e përshtatjes së tyre me kushtet dhe veçoritë e sistemit vendës.

Pjesë e kësaj veprimtarie ishte hartimi dhe prezantimi nga përfaqësuesit e secilit institucion i projekteve të mundshme të organizimit të punësimit të të dënuarve në institucionin e tyre. KShH-ja dhe ekspertët e tij, krahas angazhimit të shprehur për dhënien e komenteve dhe të sugjerimeve konkrete ndaj projekteve pilot të punësimit të të dënuarve në burgjet lokale²⁸, rekomanduan shpejtimin e hapave për përmirësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë si edhe nisjen nga zbatimi i projekteve konkrete për punësimin e të dënuarve.

Në këtë aktivitet morën pjesë drejtuesit, shefat e edukimit, të logjistikës dhe të financës të burgut nr. 325 dhe atij 313, në Tiranë, të burgut të Kosovës, Peqinit, Lezhës dhe Rrogozhinës si dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në këtë tryezë ofruan ekspertizën e tyre ekspertët e huaj z. Jan van den Brand, z. Cees Boeij si edhe z. Peeter Naks²⁹, nga Misioni i Euraliusit në Shqipëri.

5.4.2 Tryeza e rrumbullakët “Decentralizimi dhe policimi në komunitet”

Disa organizata jofitimprurëse, si: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Qendra për Studime Parlamentare, Forumi i Mendimit të Lirë, me mbështetjen e fondacionit SOROS.

²⁶ Veprimtaria u realizua në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri”, i mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

²⁷ Modele të ndryshme të punësimit iu ofruan të pranishmëve nga vende, si: Estonia, Holanda, Çekia, Kroacia dhe Norvegjia.

²⁸ Përfaqësuesit e DPB-së do të paraqesin së shpejti pranë KShH-së projektet pilot për punësimin e të dënuarve.

²⁹ Ekspert për çështjet penitenciare në Misionin e Euraliusit në Shqipëri.

organizuan tryezën e rrumbullakët “Decentralizimi dhe policimi në komunitet” për të diskutuar në tërësi projektligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe, në veçanti, atë pjesë ku bëhet fjalë për decentralizimin dhe policimin në komunitet (1 dhjetor 2006).

Pjesëmarrësit në takim u kufizuan vetëm në dispozitat ku bëhet fjalë për policimin në komunitet, për të cilat u bënë mjaft vërejtje. Duke vlerësuar rëndësinë e veçantë të projektligjit, dhe rolin e organizatave të të drejtave të njeriut dhe atyre që kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve të policisë me publikun, u sugjerua dhënia e oponencës ligjore për këtë projekt në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Të ftuar dhe pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, ekspertë vendorë, përfaqësues të Policisë së Shtetit, ekspertë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të misioneve PAMECA dhe ICITAP, Këshillit të Europës, përfaqësues të medias etj.

5.4.3 Tryeza e rrumbullakët “Respektimi i të drejtave të të miturve në procesin penal”³⁰

Në datën 5 dhjetor 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi tryezën e rrumbullakët me temë: “Respektimi i të drejtave të të miturve në procesin penal”. Qëllimi i tryezës ishte paraqitja e gjetjeve kryesore të dala nga monitorimi i kryer për respektimin e të drejtave të fëmijëve – autorë të veprave penale - në gjykatat shqiptare si dhe nxitja e organeve politikëbërëse për respektimin e të drejtave të të miturve.

Znj. Etilda Saliu, koordinatorë e projektit dhe znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së prezantuan objektivat e projektit dhe të studimit, përfundimet e dala nga studimi si dhe dhanë rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës së të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Në tryezë morën pjesë gjyqtarë të gjykatave të vëzhguara, prokurorë, avokatë, përfaqësues të Konferencës së Gjyqtarëve, të Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, juristë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të klinikave që ofrojnë shërbime ligjore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, ekspertë të përfshirë në studim, korrespondentë dhe aktivistë të KShH-së. Tryeza gjeti pasqyrim nga disa media të shkruara dhe elektronike.

5.4.4 Tryeza e rrumbullakët “Menaxhimi i integruar i kufijve, trajtimi i shtetasve të huaj dhe respektimi i të drejtave të njeriut”

Në kuadër të asistencës që Komiteti Shqiptar i Helsinkit po i jep Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, pranë Ministrisë së Brendshme, më 9 tetor 2006 u zhvillua tryeza e rrumbullakët me temë: “Menaxhimi i integruar i kufijve, trajtimi i shtetasve të huaj dhe respektimi i të drejtave të njeriut”. Qëllimi i tryezës ishte paraqitja e gjendjes aktuale të menaxhimit të kufijve, problemet e ndeshura, respektimi i të drejtave të njeriut, sfidat dhe objektivat për të ardhmen.

Krahas reformës ligjore, objekt trajtimi në tryezë ishin: masat e marra për krijimin e një strukture efikase të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Migracionit, bazuar në rekomandimet e BE-së për menaxhimin e integruar të kufijve; krijimi i infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit me BE; krijimi i kushteve akomoduese në qendrat pritëse transite në pikat kryesore kufitare etj.

Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues të organizatave të ndryshme joqeveritare që punojnë në këtë fushë si dhe përfaqësues të përfaqësive diplomatike në Shqipëri. Në përfundim të tryezës u përgatit një njoftim për shtyp.

³⁰ Ky aktivitet u mbështet financiarisht nga CORDAID-i.

6. KËSHILLIME LIGJORE

6.1 KSHH-ja vazhdon dhënien e këshillimeve ligjore për të dënuarit

Gjatë periudhës tetor – dhjetor 2006, KShH-ja ka vazhduar dhënien e këshillimeve ligjore falas për të dënuarit, informimin e të dënuarve me të drejtat dhe detyrat e tyre të përcaktuara në ligj. Përzgjedhja e temave ligjore që janë diskutuar me të dënuarit në burgje, është bërë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e stafit që punon në këto institucione, të cilat kanë dalë nga puna e tyre e përditshme, si dhe në bazë të interesave individualë të të dënuarve. Rëndësia e këtij aktiviteti qëndron jo vetëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e të dënuarve lidhur me të drejtat dhe detyrat e tyre në institucionet e riedukimit, por edhe në ndihmën praktike që KShH-ja i jep personelit të burgjeve në punën e tyre të përditshme me qëllim respektimin më të mirë të të drejtave të të dënuarve. Këshillimi ligjor është vlerësuar si i domosdoshëm nga ana e të dënuarve.

Në përfundim të raundit të takimeve këshillimore, KShH-ja ka informuar zyrtarisht institucionet përgjegjëse për gjetjet e takimeve, si dhe u ka adresuar rekomandime për respektimin e të drejtave të të dënuarve.


KShH-ja ka kryer takime këshillimore në institucionet e riedukimit në Peqin, Tepelenë, Lezhë, Burrel dhe Kosovë.

6.2 Shtetasit i drejtohet KSHH-së

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006 KShH-ja ka trajtuar **52 letra dhe ankesa**. Objekti i tyre kanë qenë: shkelja e të drejtave të të dënuarve në burgje, ushtrimi i dhunës nga administrata e burgjeve, shkelja e të drejtave në marrëdhëniet e punës, ankesa për organet gjyqësore etj. Ankesat janë marrë nga takimet në zyrë të shtetasve me juristë të KShH-së, nëpërmjet letrave drejtuar në adresën e KShH-së, këshillimeve ligjore etj.

KShH-ja u ka kthyer përgjigje qytetarëve duke u dhënë këshillimin përkatës si dhe u ka kërkuar autoriteteve shtetërore të ndërhyjnë për të zgjidhur çështjet konkrete.

Paraqitja grafike e ankesave



7. RASTE TË VERIFIKUAR NGA KSHH-JA

Përveç trajtimit të letrave dhe të ankesave të qytetarëve, KShH-ja ka verifikuar raste në të cilat është pretenduar për shkeljen e të drejtave të njeriut.

- Në datën 11 dhjetor 2006, një grup vëzhguesish të KShH-së verifikuan ankesat e ardhura nga disa të paraburgosur në komisariatit e policisë, në Berat. Objekti i ankesave të tyre ishin kushtet e këqija në dhomat e paraburgimit, mungesa e shërbimit shëndetësor, e ilaçeve dhe cilësia e dobët e ushqimit. Për këto arsye, të gjithë të paraburgosurit e komisariatit të policisë në Berat ishin futur në grevë urie. Gjatë verifikimit nga ana e grupit vëzhgues, rezultuan një sërë mangësish lidhur me garantimin e kushteve normale të jetesës, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, krevatëve dhe të pajisjeve të tjera të nevojshme, mungesën e shërbimit stomatologjik etj. Si rezultat i ndërhyrjes së KShH-së pranë drejtuesve të komisariatit, të paraburgosurit dolën nga greva e urisë.
- Në datën 16 nëntor 2006, nisur nga një ankesë anonime ku pretendohet ushtrim dhune nga ana e administratës së burgut të Krujës ndaj dy të dënuarve që vuanin dënimin në këtë institucion, KShH-ja vuri në dijeni organin e prokurorisë së rrethit të Krujës për marrjen e masave konkrete. Sipas informacionit të dërguar nga kjo prokurori në adresë të KShH-së, ndaj punonjësve që kanë ushtruar dhunë, është marrë masa e pushimit nga detyra dhe ka nisur procedimi penal.
- Në datën 12 dhjetor 2006, në adresë të KShH-së ka ardhur një ankesë telefonike nga një qytetare e cila ankohej për ushtrim dhune ndaj djalit të saj të dënuar, me iniciale V.L., që vuan dënimin në burgun e Tepelenës. Për verifikimin e këtij rasti, KShH-ja ka vënë në dijeni menjëherë prokurorinë e rrethit gjyqësor Tepelenë. Nga hetimi paraprak nga ky organ ka rezultuar se ankesa nuk ishte e vërtetë³¹.
- Në datën 10 nëntor 2006, një grup i KShH-së realizoi verifikimin e një ankimi të qytetarëve lidhur me publikimin nëpërmjet një ekrani të madh në hyrje të qendrës “Euromax”, pranë Qendrës Tregtare Univers, të fytyrave të rreth 20 personave që ishin kapur duke vjedhur në këtë dyqan dhe që shpallehin si persona “non grata”. Nisur nga fakti që publikimi i fytyrave të personave shkelte parimin e prezumimit të pafajësisë, KShH-ja realizoi takime me përfaqësuesit administrativë dhe ligjorë të qendrës “Euromax”. Ende nuk është marrë një përgjigje zyrtare nga administratorët e kësaj qendre.

8. REAGIME PUBLIKE TË KSHH-SË

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006, KShH-ja, nëpërmjet **5 deklaratave publike dhe 2 njoftimeve për shtyp** ka reaguar për çështje të tilla, si: e drejta e informimit; ushtrimi i dhunës ndaj ish-kreut të SHISH-it; respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë; respektimi i të drejtave të fëmijëve³².

9. KOMUNIKIME ME AUTORITETET SHTETËRORE

³¹ Një pjesë e ankesave të ardhura për verifikim nga ana e të dënuarve janë trajtuar gjatë takimeve këshillimore që KShH-ja ka organizuar në burgje të ndryshme.

³² Për më gjerë, shih shtojcën nr. 1

KShH-ja ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet shtetërore³³, kryesisht për: trajtimin e ankesave të ardhura në adresë të KShH-së, paraqitjen e problematikës së dalë nga vëzhgimi, dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme ligjore dhe praktike, raportim lidhur me aktivitetet e realizuara nga KShH-ja etj.

Komunikimet janë realizuar kryesisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, drejtoritë e institucioneve të riedukimit, Prokurorinë e Përgjithshme e prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin e Shqipërisë etj.

10. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS

10.1 Plani strategjik dhe biznesplan i KSHH-së - 2007 - 2010

Edhe gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006, KShH-ja ka vazhduar punën në kuadër të hartimit të planit strategjik dhe biznesplanit 2007-2010. Pjesë e këtij procesi ka qenë analiza e treguesve financiarë të organizatës e cila u realizua nga z. Klaas Astma dhe znj. Amalia Tole. Përfundimet e analizës financiare do të shërbejnë për hartimin e planit strategjik të KShH-së.

10.2 NGRITJE E KAPACITETEVE TË KSHH-SË

10.2.1 Trajnimi i stafit dhe i korrespondentëve të KSHH-së

Në kuadër të bashkëpunimit dhe me qëllim rritjen e profesionalizmit të punës së korrespondentëve të OSBE-së dhe të KSHH-së në rrethet përkatëse, në tetor të vitit 2006, OSBE-ja realizoi një trajnim të korrespondentëve të saj dhe të korrespondentëve dhe stafit të KShH-së. Trajnimi synonte të ngrinte kapacitetet e pjesëmarrësve në kuadër të studimit të dosjeve penale në gjykatë.

10.2.2 Trajnimi “Respektimi i të drejtave të minoriteteve dhe promovimi i interkulturalizmit në Shqipëri”

Më 24 tetor 2006, PNUD-i organizoi trajnimin e trajnerëve “Respektimi i të drejtave të minoriteteve dhe promovimi i interkulturalizmit në Shqipëri”. Trajnimi ishte vazhdimi i disa seancave trajnuese dhe vinte pas përgatitjes së një manuali për trajnerë në fushën e minoriteteve. Bazuar në manualin e përgatitur, trajnimi trajtoi tema të rëndësishme në fushën e minoriteteve, si: diversiteti dhe diskriminimi, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, legjislacioni ndërkombëtar, minoritetet dhe media, kultura rome dhe egjiptiane etj. Metodologjia e përdorur ishte interaktive, duke u dhënë mundësi pjesëmarrësve të diskutonin për temat e trajtuara. Në trajnim merrnin pjesë përfaqësues të organizatave rome, egjiptiane dhe të organizatave të tjera që punojnë në fushën e minoriteteve. Nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit morën pjesë Klesta Alikaj dhe Etilda Saliu

10.2.3 Trajnimi i vëzhguesve dhe i korrespondentëve të KSHH-së “Studimi i vendimeve penale dhe vëzhgimi i proceseve gjyqësore për të miturit në gjykatat e rretheve gjyqësore”

Më 22 shtator 2006, KShH-ja organizoi një sesion trajnimi të vëzhguesve dhe të korrespondentëve të KShH-së lidhur me studimin e vendimeve penale të formës së prerë, për

³³ Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006 ka pasur 20 letra dalëse dhe 21 letra hyrëse, kryesisht komunikime me institucione të ndryshme shtetërore.

vitin 2005 dhe gjysmën e vitit 2006, me autor të miturin³⁴. Objekt i trajnimit ishte dhënia e metodologjisë së studimit të vendimeve penale të formës së prerë dhe e vëzhgimit të proceseve gjyqësore me autor të miturin. Gjatë trajnimit u trajtuan një sërë çështjesh të aspektit ligjor dhe atij praktik. Çështjet ligjore që u trajtuan, ishin: zbatimi i nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për një proces të drejtë gjyqësor; parimet procedurale penale; të drejtat e të miturve në një proces penal; dhënia e rasteve më të mira nga praktika shqiptare dhe ajo ndërkombëtare etj. Gjithashtu, gjatë trajnimit u dhanë udhëzime për pjesën praktike të vëzhgimit, studimit dhe raportimit.

Në këtë trajnim merrnin pjesë disa juristë dhe studentë të Fakultetit të Drejtësisë të përzgjedhur në rrethet ku do të shtriheshin studimi, si dhe korrespondentë në rrethet Tiranë, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Shkodër, Elbasan dhe Fier. Trajnimi u ofrua nga Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive dhe eksperte në këtë fushë, Alma Fatkoja, juriste dhe Etilda Salii, koordinatore e projektit në fjalë.

11. PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË NDRYSHME

- ▶ Në datën 13 tetor 2006, drejtorja e institucionit të paraburgimit në rrugën “Jordan Misja” (paraburgimi nr. 313), në Tiranë, organizoi një aktivitet të titulluar “Minispartakiada sportive”. Kjo veprimtari kishte për qëllim përmirësimin e trajtimit të paraburgosurve në institucionet e heqjes së lirisë si dhe edukimin e tyre për rikrijimin e aftësive për integrimin e tyre në shoqëri. Ishin të ftuar përfaqësues të lartë nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, figura të njohura të futbollit shqiptar si edhe përfaqësues të shoqërisë civile që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të të paraburgosurve, mes tyre edhe të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.
- ▶ Në datën 20 tetor 2006, PNUD-i dhe UNIFEM-ja organizuan një tryezë të rrumbullakët në kuadër të promovimit të programit rajonal i cili synon zhvillimin e zbatimit të legjislativitetit evropian për barazinë gjinore, duke u fokusuar në realizimin e të drejtave të grave në vendin e punës. Përfaqësueset e KShH-së në këtë veprimtari, ishte znj. Klesta Alikaj.
- ▶ Në datën 26 tetor 2006, USAID-i, Chemonics dhe Partners organizuan një tryezë të rrumbullakët për të prezantuar fillimin e zbatimit të një projekti të ri për taksat dhe administrimin e tyre, prokurimet publike dhe regjistrimin e bizneseve. Në tryezën e rrumbullakët u paraqitën qëllimet kryesore të projektit. Të ftuar ishin pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe institucionet shtetërore. KShH-ja shprehu qëndrimet e veta lidhur me regjistrimin e OJF-ve.
- ▶ Në datën 5 dhjetor 2006, Bashkimi Evropian, CCF në Shqipëri, Un Enfant Par La Main dhe Pomoc Deci organizuan një konferencë me rastin e përfundimit të projektit “Bashkëpunimi, integrimi dhe fuqizimi i grupeve të minoriteteve etnike në Shqipëri dhe në Serbi”. Në këtë konferencë u bë prezantimi i objektit të projektit si edhe u paraqitën përfundimet kryesore të dala prej tij për gjendjen e minoritetit rom. E pranishme në këtë aktivitet ishte koordinatoreja e projektit të minoriteteve të KSHH-së, Klesta Alikaj.
- ▶ Në datën 11 dhjetor 2006, Avokati i Popullit organizoi konferencën kombëtare “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për personat me aftësi të kufizuara” në të cilën u paraqitën aspekte të ndryshme të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në aspektin ligjor dhe të masave konkrete që ka marrë shteti shqiptar për zhvillimin e tyre. Të ftuar në këtë konferencë ishin

³⁴ Ky aktivitet u realizuan në kuadër të projektit „Respektimi i interesit më të lartë të fëmijës – detyrim për të gjithë”, mbështetur financiarisht nga fondacioni SOROS dhe CORDAID-i.

përfaqësues nga institucionet shtetërore, nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat vendëse dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. KShH-ja vlerësoi trajtimin e grupeve të tilla, si grupe në nevojë dhe të cilat kërkojnë më shumë përkujdesje.

Aneks 1

Tiranë, më 9 Tetor 2006

NJOFTIM PËR SHTYP

Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit organizojnë tryezën e rrumbullakët me temë “Menaxhimi i Integruar i Kufijve” trajtimi i shtetasve të huaj dhe respektimi i të drejtave të njeriut”.

Qëllimi i tryezës është të paraqesë gjendjen aktuale të menaxhimit të kufijve, problemet e ndeshura deri më sot, respektimi i të drejtave të njeriut, sfidat dhe objektivat për të ardhmen.

Në fokus të punës së policisë kufitare dhe migracionit është zbatimi i strategjisë “Për menaxhimin e integruar të kufijve” së bashku me planin e veprimit (e cila po ripunohet); përmirësimi i legjislacionit për të huajt, zbatimi i Strategjisë “Për migracionin” dhe plani i saj i veprimit, zbatimi i standarteve ndërkombëtare “Për përzgjedhjen e shtetasve të huajve” dhe zbatimi i marrëveshtjes së ripranimit të nënshkruar me Bashkimin Europian.

Krahas reformës ligjore, objekt trajtimi në tryezë janë masat e marra për krijimin e një strukture efikase dhe dhënia e një autonomie më të madhe Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Migracionit bazuar në rekomandimet e BE për menaxhimin e integruar të kufijve si dhe në praktikat e mira; rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar; midis strukturave vendase qendrore dhe rajonale; krijimi i infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e marrëveshjes së ripranimit me BE, krijimi i kushteve akomoduese në qendrat pritëse tranzit në pikat kryesore kufitare, masat e marra për kontrollin e shtetasve të huaj në territor.

Respektimi i të drejtave dhe lirive të shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi, në pikat e kalimit të kufirit, trajtimi human dhe me dinjitet i viktimave të trafikut të qënieve njerëzore është një çështje që do të diskutohet në tryezë.

Megjithë arritjet në këtë fushë, mbetet ende për tu bërë për të përmbushur objektivat afat mesëm dhe afatgjatë për një menaxhim sa më të mirë të kufijve dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e lëvizjes së lirë të njerëzve.

Monitorimi periodik i kufijve, informimi dhe sensibilizimi i shtetasve për të drejtat e tyre, rritja e kapaciteteve të personelit të policisë kufitare lidhur me trajtimin me respekt dhe dinjitet të shtetasve dhe personave të kthyer sipas marrëveshjes së ripranimit, etj., janë elemente të rëndësishëm në punën e policisë së kufirit dhe të migracionit dhe organizatave monitoruese të të drejtave të njeriut.

Në këtë takim marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe Migracionit, të organizatave ndërkombëtare, të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Tiranë, përfaqësues të organizatave të të drejtave të njeriut dhe të organizatave që ofrojnë shërbime në fushën e trajtimit të të huajve, migrantëve dhe azil kërkuesve.

Tiranë, më 12 Tetor 2006

Të rivendoset e drejta e Informimit në Kuvendin e Shqipërisë

Sipas njoftimit për shtyp, Drejtori i Marrëdhënieve me Publikun pranë Kuvendit të Shqipërisë ka njoftuar zyrtarisht redaksitë e mediave private se duke filluar nga data 10 Tetor 2006 nuk do të lejohen transmetimet direkte të zhvillimit të seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Sipas kësaj shkrese, marrja e një mase të tillë arsyetohet me nevojën e nënshkrimit të kontratave të specifikuara me televizionet private.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH-ja) e konsideron këtë urdhër jo vetëm të nxituar, por edhe si një veprim që bie ndesh me të drejtën e marrjes së informacionit dhe faktin që transmetimi i informacionit publikut të gjerë pa asnjë lloj censurimi është i garantuar nga dokumentat ndërkombëtare, Kushtetuta e RSH-së dhe ligji për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë.

Në bazë të nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, mbledhjet e Kuvendit bëhen të hapura, me përjashtim të rasteve kur zhvillimi i mbledhjeve me dyer të mbyllura kërkohet nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryeministri ose 1/5 e deputetëve të Kuvendit dhe kur për këtë kanë votuar shumica e deputetëve.

Gjithashtu, neni 105 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, parashikon se veprimtaria e tij është e hapur dhe realizohet nëpërmjet "...pasqyrimin të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në median e shkruar dhe vizive".

KSHH çmon se çdo paqartësi ose boshllëk që mund të ekzistonte në Rregulloren e Kuvendit ose në dispozita të tjera lidhur me këtë çështje nuk duhet të çonte deri në lëshimin e urdhërave të tilla.

KSHH i sugjeron Kuvendit të Shqipërisë që të rivendosë me urgjencë të drejtën e shkelur për marrjen e informacionit me transparencë dhe të mos e kushtëzojë atë me hartimin ose miratimin e procedurave formale ose administrative.

Tiranë, më 1 Nëntor 2006

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dënon dhunën ndaj ish Drejtorit të SHISH-it

Sipas njoftimeve të medias, dje në datën 31 Tetor 2006, ish Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit z. Fatos Klosi kur po dilte nga banesa e tij, u ndal dhe u godit nga një person i panjohur, që siç u vërtetua ishte punonjës i këtij shërbimi gjatë periudhës 1992-1998 Anibal Basha.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dënon këtë akt të shëmtuar, këtë veprim me rrezikshmëri shoqërore që vuri në rrezik shëndetin dhe jetën e z. Klosi. Megjithëse, motivet e vërteta të kësaj ngjarjeje do t'i vërtetojnë organet kompetente, të dhënat paraprake të deritanishme të pranuar edhe nga vetë i ndaluari, flasin për një reagim të menjëhershëm ndaj sqarimeve të dhëna publikisht nga z. Fatos Klosi lidhur me rrëmbimin dhe zhdukjen e Remzi Hoxhës.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e dënon fuqimisht këtë akt edhe për faktin se veprime të tilla ndaj shtetasve të veçantë (në rastin konkret z. Klosi) synojnë t'u mbyllin gojën atyre që të mos flasin dhe të mos bëjnë publike atë që mund të dinë për një ngjarje të caktuar ose për një vepër penale që mund të jetë kryer.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit me këtë rast e shikon të nevojshme t'u sugjerojë organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës që ta shqyrtojnë çështjen me përparësi dhe objektivitet.

KSHH mendon se qoftë edhe vetëm ky fakt tregon sa i nevojshëm dhe i drejtë ishte miratimi i ligjit "Mbi mbrojtjen e dëshmitarëve".

Tiranë, më 6 Nëntor 2006

Të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe pavarësia e gjykatës

Më datën 3 Nëntor 2006, Prokuroria i ka drejtuar Gjykatës së Tiranës kërkesën për vlerësimin e masës së sigurimit ndaj pesë personave: Niko Dhima, Maxhit Alibali, Shpëtim Peza, Faik Ymeri dhe Alban Doda. Ata akuzohen për legalizimin e dokumentave të falsifikuar në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë së Jashtme.

Gjykata, më datën 4 Nëntor 2006 mori në shqyrtim kërkesën e mësipërme dhe vendosi për dy të parët burg pa afat, për të tretin (Shpëtim Pezën), 20 ditë burg me qëllim që prokuroria gjatë hetimeve të përcaktonte rolin e tij në kryerjen e kësaj vepre, ndërsa për Faik Ymerin dhe Alban Dodën në mbështetje të nenit 134 të Kodit të Procedurës Penale, urdhëroi lirim dhe detyrimin e tyre për paraqitje në organin e hetimit.

Të nesërmen e këtij vendimi me datën 5 Nëntor 2006, reagoi Ministria e Brendshme nëpërmjet zëdhënësit të tij në një konferencë për shtyp. Në deklaratën e tij para mediave ai e quajti "absurd" lirim dhe Faik Ymerit dhe Alban Dodës, se në ngarkim të tyre kishte "Prova të mjaftueshme dhe të pakundërshtueshme", se "Gjykata e Tiranës, me një shkelje flagrante la të lirë sekserët kryesorë Faik Ymerin dhe Alban Dodajn. Ministria e Brendshme shpreh shqetësimin e saj në lidhje me këtë çështje ku puna disa mujore për zbulimin e këtij grupi, grumbullimi i dhjetra provave e paraqitja e shumë dokumentave sabotohen dhe bëhen të pavlefshme nga organi i drejtësisë".

Komiteti Shqiptar i Helsinkit e shikon të nevojshme të theksojë se kompetencat e çdo organi, pra edhe ato të Prokurorisë, gjykatës, policisë gjyqësore, Ministrisë së Punëve të Brendshme etj., janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në dispozitat përkatëse ligjore.

Në këtë vështrim, KSHH disa herë edhe më parë ka reaguar publikisht ndaj deklaratave që bien ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë, të sanksionuara në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 30 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

Zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme duke u shprehur për prova “të pakundërshtueshme”, ka cënuar në mënyrë të hapur këtë parim, sepse ka marrë atributet e gjykatës, madje të gjykatës që deklaroi fajtor personin e akuzuar me vendim të formës së prerë. Vlen të përmendet se gjykata ka vendosur konform kërkesës së prokurorit.

KSHH thekson se as Prokurorisë që është i vetmi organ i ndjekjes penale dhe që me këtë cilësi ka kërkuar nga gjykata vlerësimin e masës së sigurimit, nuk do t’i lejohej një deklaratë e tillë. E vetmja e drejtë e saj, në qoftë se në rastin konkret nuk do të pajtohej me vendimin e gjykatës, do të ishte ankimi në gjykatën më të lartë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit konsideron tepër të nxituar dhe të papranueshme edhe atë pjesë të deklaratës të zëdhënësit të Ministrisë së Brendshme që e etiketon gjykatën si “sabotuese” të punës së kryer për zbulimin e këtij grupi.

Për KSHH-në, shprehje të tilla qoftë edhe në mënyrë indirekte, përbëjnë presion ndaj gjykatës kur dihet se: “Gjyqtarët janë të pavarur dhe i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”, se “Ndërrhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit” (Neni 145 i Kushtetutës).

Meqë rastet e cënimit të parimit të prezumimit të pafajësisë janë të përsëritura dhe meqë ato mund të shoqërohen me pasoja të dëmshme, Komiteti Shqiptar i Helsinkit u bën thirrje funksionarëve të shtetit dhe zyrtarëve të lartë si dhe të gjithë administratës publike që ta respektojnë këtë parim të rëndësishëm kushtetues.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në disa vendime të saj ka theksuar se ky parim duhet të zbatohet edhe nga administrata publike.

Tiranë, 17. 11. 2006

ALEANCA PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI,
DIAKONIA AGAPES,
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
QËNDRA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI – CRCA
SOS-FSHATI I FËMIJËVE
UNIONI AMARO- DROM

DEKLARATË PËR SHTYP

QEVERIA SHQIPTARE TË MARRË MASAPËR T’IDHËNE FUND ABUZIMIT TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Drejtuar: Z. Sali Berisha
Kryeminister
Qeveria e Republikës së Shqipërisë

Per dijeni: **Znj. Jozefina Topalli** Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Minister i Arsimit dhe i Shkencës,
Z. Koço Barka Minister i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,
Z. Aldo Bumçi Ministër i Drejtësisë,
Z. Maksim Cikuli Ministër i Shëndetësisë

Për njoftim: **Massmedias në Shqipëri**
OJF-ve në Shqipëri

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA, Aleanca për Fëmijët në Shqipëri, Sos-Fshati i Fëmijëve, Diakonia Agapes, Unioni i Rromeve të Shqipërisë “Amaro-Drom” dhe Komiteti

Shqiptari i Helsinkit me rastin e Dites Botërore Kundër Abuzimit të Fëmijëve kerkojnë të shprehin shqetësimin e tyre për situatën e rëndë dhe dhunën që i nënshtrohen çdo ditë në familje, në shkollë dhe në shoqëri, me qindra-mijëra fëmijë në Shqipëri.

Sot në të gjithë botën organizohen aktivitete me mesazhin e përbashkët “Një Botë pa Dhunë për Fëmijët”. Edhe në Shqipëri Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA, Aleanca për Fëmijët në Shqipëri, Sos - Fshati i Fëmijëve, Diakonia Agapes, Unioni i Rromeve të Shqipërisë “Amaro-Drom” dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizojnë aktivitete ndërgjegjësuese në të gjithë Shqipërinë për t’i thënë ndal dhunës kundër fëmijëve.

Dhuna ndaj fëmijëve vazhdon të mbetet një problem madhor në Shqipëri dhe përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në vend. Sipas studimit më të fundit të UNICEF “Dhuna Kundër Fëmijëve në Shqipëri” rezultojnë se 1 në 4 fëmijë janë viktime të formave më të rënda të dhunës në familje dhe 1 në 3 fëmijë janë viktime të dhunës në shkollë.

Neni 39 i KDF-së thotë “Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të lehtësuar ri-aftësimin fizik dhe psikologjik dhe ri-integrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo lloj tjetër dënimi mizor”, ndërsa Kushtetuta e Shqipërisë ndër të tjera në Nenin Nr 54 të saj thotë: “...Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë...”

Ndonëse Shqipëria ka bërë hapa përpara përpara për të respektuar të drejtat e fëmijëve, dhuna ndaj fëmijëve është një nga ato çështje që nuk ka gjetur pasqyrim në politikën e Qeverisë apo në legjislacionin shqiptar. Është e papranueshme që në vitin 2006 ushtrimi i dhunës ndaj fëmijëve të mos ndalohet me ligj.

Pasojat e dhunës ndaj fëmijëve janë edhe pasoja direkte mbi shoqërinë shqiptare. Këto pasoja sot mund të shihen qartë në dhunën e vazhdueshme që shoqëron punimet e Kuvendit të Shqipërisë, apo edhe numrin e lartë të krimeve kundër jetës së personit. Ne besojmë se ka ardhur koha që Qeveria Shqiptare, si të gjitha vendet demokratike në botë, ti thotë “Ndal Dhunës ndaj Fëmijëve” duke përgatitur një ligj që ndalon përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve, si dhe duke krijuar infrastrukturën e duhur për rehabilitimin e fëmijëve viktime të dhunës.

Duke patur parasysh shqetësimet e ngritura në këtë Deklaratë për Shtyp, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA, Aleanca për Fëmijët në Shqipëri, Diakonia Agapes, SOS-Fshati i Fëmijëve, Unioni i Rromeve të Shqipërisë “Amaro-Drom” dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit mendojnë se Qeveria Shqiptare, ndër të tjera duhet të ndërmarrin masat e mëposhtme:

1. Vendosija në prioritetet e Qeverisë shqiptare të çështjeve të fëmijëve dhe në veçanti të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë dhe shoqëri.
2. Qeveria shqiptare të miratojë një ligj që ndalon një herë e përgjithmonë ushtrimin dhe përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve.
3. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Brendshme të marrin masa për të përmirësuar standartet dhe nivelin e shërbimeve për fëmijët viktime të dhunës.

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri-CRCA, Aleanca për Fëmijët në Shqipëri, Diakonia Agapes, SOS-Fshati i Fëmijëve, Unioni i Rromeve të Shqipërisë “Amaro-Drom” dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, besojnë se zbatimi i këtyre masave si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërisë së institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për krijimin e një sistemi parandalues, mbrojtës, trajtues dhe ri-integrues për fëmijët viktime të dhunës, do të sillnin një përmirësim të ndjeshëm të situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Tiranë, 1 Dhjetor 2006

**QENDRA PER MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE FEMIJEVE NE SHQIPERI
GRUPI SHQIPTAR PER TE DREJTAT E NJERIUT
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
QENDRA E ALEANCES GJINORE PER ZHVILLIM
QENDRA PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN
SHOQATA KRISTIANE E GRAVE SHQIPTARE
UNIONI "AMARO DROM"**

DEKLARATË PËR SHTYP

NDAL DISKRIMINIMIT TE FEMIJEVE QE JETOJNE ME HIV / AIDS NE SHQIPERI

Drejtuar:

Znj. Jozefina Topalli	Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë
Z. Tritan Shehu	Kryetar i Komisionit të Shëndetësisë
znj. Valentina Leskaj	Kryetare e Komisionit të Arsimit dhe Medias
znj. Majlinda Bregu	Kryetare e Nen-Komisionit per te Miturit
Z. Sali Berisha	Kryeministër i Republikës së Shqipërisë
z. Genc Pollo	Ministër i Arsimit dhe Shkencës
z. Maksim Cikuli	Ministër i Shëndetësisë

Për njoftim: Massmedias dhe OJF-ve ne Shqiperi

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Shoqata Krisitiane e Grave Shqiptare dhe Unioni "Amaro Drom", me anë të kësaj deklarate për shtyp kërkojnë të shprehin shqetësimin e tyre të thellë për diskriminimin e fëmijëve që jetojnë me HIV / AIDS në Shqipëri në drejtim të aksesit të tyre në shërbimet sociale, shëndetësore, por sidomos në arsimin publik.

Sot në Shqipëri ka 11 fëmijë të cilët janë të prekur nga HIV / AIDS, ndërkohë që një fëmijë ka vdekur. Kjo tregon se mungesa e vëmendjes për këta fëmijë mund t'i vendosë ata në rrezikun e humbjes së jetës së tyre. Ndonëse shifrat në dukje janë të ulta, ato duhet të përbëjnë një bazë për shqetësim për Parlamentin dhe Qeverinë e Shqipërisë.

Rasti më i fundit i diskriminimit të hapur të aksesit në shërbime ka të bëjë me institucionet e arsimit parashkollor (kopshtet publike) - në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të cilat iu refuzojnë fëmijëve që jetojnë me HIV/AIDS të drejtën për të frekuentuar këto institucione.

Kjo është një shkelje flagrante e të drejtave të fëmijëve dhe në kundërshtim të hapur me Nenin 28 të Konventës për të Drejtat e Femijëve të OKB-së, ku shteti shqiptar është palë që prej vitit 1992, si dhe Nenit 21 të ligjit Nr. 8689, datë 16.11 2000 "Per parandalimin e perhapjes se infeksionit HIV/AIDS ne Republikën e Shqiperise" dhe të angazhimeve të marra nga Qeveria Shqiptare gjatë nënshkrimit të Deklaratës së UNGASS-it të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Qershor 2006.

Mendojmë se është e papranueshme për Parlamentin, Qeverinë Shqiptare dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, që të lejojnë institucionet në varësi të tyre, të financuara nga taksapaguesit shqiptarë, përfshirë edhe personat që jetojnë me HIV/AIDS, të diskriminojnë dhe të shkelin në mënyrë flagrante të drejtën e femijëve për të patur akses në shërbimet publike.

Në Nenin 2 të Konventës për të Drejtat e Femijës të OKB-së shprehet tekstualisht se: "Shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi....." për të vazhduar më tej "Shtetet palë marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit..."

Ndërsa në legjislacionin shqiptar në Nenin 21, të Ligjit Nr. 8689 të lartpërmendur është përcaktuar shprehimisht: "Janë të ndaluara: pushimi nga puna, mospranimi në punë, mospranimi në një institucion arsimor, shëndetësor, kufizimet e të drejtave të tjera dhe të interesave të ligjshëm... si për personat e

infektuar nga HIV-i dhe për anëtarët e familjeve të tyre duke nxjerrës si shkak infeksionin me HIV/AIDS”.

Sot fëmijët që jetojnë me HIV / AIDS në Shqipëri i kanë të garantuara ilaçet antivirale, që është një arritje pozitive e Qeverisë së Shqipërisë dhe institucioneve të saj. Por shumë prej këtyre fëmijëve përballen me frikën, paditurinë, stigmën dhe mentalitetin e shoqërisë dhe përfaqësuesve të shtetit, gjë që e bën integrimin në shoqëri të fëmijëve tepër të vështirë. Ne nuk do të dëshironim të besojmë se mentaliteti, stigma dhe diskriminimi ka përfshirë edhe institucionet publike në Shqipëri. Kjo do të krijonte premisa që diskriminimi i fëmijëve të shtrihej në të gjitha nivelet e shërbimeve publike në Shqipëri, gjë e cila do të binte ndesh edhe me legjislacionin dhe politikën e Qeverisë Shqiptare.

Sot fëmijët që jetojnë me HIV / AIDS nuk kanë nevojë vetëm për mjekime. Ata kanë nevojë për të qenë të respektuar në të drejtën e tyre për të jetuar të lirë; të gëzojnë të drejta të barabarta dhe të garantuara si ndaj të gjithë fëmijëve të tjerë; të kenë mbrojtje sociale, shëndetësore dhe arsimore. Të kërkojnë respektimin e të drejtave bazë të fëmijëve dhe të presësh që Qeveria dhe institucionet e saj t’i respektojnë dhe garantojnë këto të drejta nuk është shumë.

Duke patur parasysh shqetësimet e ngritura në këtë Deklaratë për Shtyp, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Shoqata Krisitiane e Grave Shqiptare dhe Unioni “Amaro Drom”, rekomandojmë që Qeveria Shqiptare dhe institucionet e saj, duhet të ndërmarrin masat e mëposhtme:

1. Rishikimin dhe amendimin brenda vitit 2007 të Ligjit për Parandalimin e Përhapjes së Infeksionit të HIV/AIDS;
2. Rishikimin dhe amendimin brenda vitit 2007 të Strategjisë Kombëtare për HIV / AIDS në Shqipëri;
3. Eliminimin e të gjitha rasteve të diskriminimit të fëmijëve në institucionet arsimore, shëndetësore dhe sociale, nëpërmjet forcimit të ndërgjegjësimit të stafëve të shërbimeve dhe vetë publikut në Shqipëri;
4. Mbrojtjen e identitetit (konfidencialitetit) të fëmijëve që jetojnë me HIV/AIDS në këto institucione;
5. Marrjen e masave serioze ndaj të gjithë zyrtarëve publik të cilët diskriminojnë dhe shkelin të drejtat e fëmijëve që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri.

Manifestime të tilla të diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të fëmijëve jo vetëm që dëmtojnë imazhin e Qeverisë shqiptare dhe institucioneve të saj, por ndikojnë edhe në krijimin e një atmosfere negative, poshtëruese dhe ndëshkuese ndaj fëmijëve që jetojnë me HIV / AIDS. Sigurisht që është ky imazh që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë negativisht edhe në integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim, Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin, Shoqata Krisitiane e Grave Shqiptare dhe Unioni “Amaro Drom”, besojnë se zbatimi i këtyre masave si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe ndjeshmërisë së institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për krijimin e një sistemi reagimi human, profesional dhe mbrojtës do të sillnin përmirësimin e situatës së fëmijëve që jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri.

Tiranë, më 5 Dhjetor 2007

Drejtësia e të miturve duhet të respektojë interesin më të lartë të fëmijës

Sot më datë 5 dhjetor 2006, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizon tryezën me temë “Respektimi i të drejtave të të miturve në procesin penal”.

Qëllimi i tryezës është paraqitja e gjetjeve kryesore të dala nga monitorimi i kryer lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve - autor të veprave penale në gjykatat shqiptare.

Në tryezë janë ftuar gjyqtarë të gjykatave të vëzhguara, prokurorë, avokatë, përfaqësues të Konferencës së Gjyqtarëve, të Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, juristë,

përfaqësues të shoqërisë civile dhe të klinikave që ofrojnë shërbime ligjore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, ekspertë të përfshirë në studim, korrespondentë dhe aktivistë të KShH-së.

Studimi u shtri në 7 gjykata të rretheve gjyqësore Tiranë, Fier, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Korçë dhe Vlorë dhe u krye gjatë periudhës shtator – nëntor 2006. U studiuan vendimet gjyqësore të periudhës periudhës 2005 dhe një pjesë të vitit 2006 dhe u vëzhguan proceset gjyqësore me të mitur të zhvilluara gjatë periudhës tetor – nëntor 2006.

Nga 218 vendime penale të dhëna nga gjykatat e shkallës së parë, me 292 të mitur të gjykuar, numri më i madh i tyre i përkasin gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë (164). Shumica e të miturve të gjykuar janë dënuar për kryerjen e veprave penale kundër pasurisë, sidomos për vjedhje të vogla. Megjithatë, ka patur të mitur të gjykuar për vjedhje me dhunë, vjedhja me armë, krime kundër jetës shkaktuar nga pakujdesia, përdorim i dokumentave të falsifikuara, vepra penale kundër drejtësisë, si moskallzim krimi, kallzim i rrëme, dëshmi e rreme etj.

41% e të miturve të gjykuar i përkasin moshës nën 16 vjeç, shumica e tyre janë meshkuj me vendbanim me qytet. Pjesa më e madhe tyre janë me arsim 9 vjeçar (136) ose me arsim fillor (65 të mitur). Kryesisht të miturit e gjykuar nuk janë të dënuar më parë (221 të mitur).

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme, e bazës nënligjore për zbatimin e alternativave, mungesa e institucioneve për trajtimin e të miturve, mungesa e ambjentëve të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e seancave publike, në disa gjykata, sidomos në gjykatën më të madhe të vendit në atë të Tiranës, mungesa e asistencës psikologjike ndaj të miturve krijon vështirësi për zbatimin e standarteve ndërkombëtare dhe vetë kërkesat e legjislacionit shqiptar lidhur me drejtësinë për të mitur. Megjithatë, gjykatat shqiptare kanë bërë përpjekje pozitive për të respektuar të drejtat e fëmijëve në proces dhe KShH-ja mbështet fuqimisht reformat që janë në interes të fëmijës.

Megjithë përpjekjet e bëra për të përmirësuar respektimin e të drejtave të fëmijëve në procesin penal, ende drejtësia penale për të mitur përballet me një sërë problemesh:

1. Gykatat kanë zbatuar ndaj të miturve detyrim për paraqitje (80), por ende *arresti në burg (96), dhe arresti në shtëpi (39) zbatohen gjërësisht.*
2. Krahasuar me veprat penale të kryera nga të miturit dhe rrezikshmërinë e tyre, *afatet e paraburgimit janë të gjata.*
3. Në të gjitha vendimet e studiura, të miturit kanë patur avokatin e tyre të zgjedhur nga familjarë (195 raste) ose të caktuar kryesisht nga prokurori ose gjykata (76 raste). *Por mbrojtja kryesisht lë për të dëshiruar.*
4. Nga vendimet gjyqësore nuk del nesë të miturve u është dhënë asistencë psikosociale gjatë procesit penal.
5. *Rreth 50% e gjykimeve kanë qënë gjykime të shkurtuara* çka tregon për përpjekje pozitive të gjyqtarëve. Megjithatë, shumica e proceseve penale ndaj të miturve kanë përfunduar brenda një afati deri 5 muaj (122 raste) dhe 77 procese penale janë zhvilluar në një afat më pak se 1 muaj (77 procese).
6. *Mungesa e sistemeve të tjera mbikqyrëse për të miturin detyron gjykatat të zbatojnë arrestin në burg dhe dënimin me burgim.* Nga organi i prokurorisë është kërkuar kryesisht dënim me burgim (143), në pak raste dënim me gjobë (34) ose pezullim të dënimit me kusht të ekzekutimit të vendimit (79). Në shumicën e vendimeve të dhëna nga gjykatat, konstatohet se dënimet dhe masat e dhëna nga gjykata përkojnë me ato të kërkuara nga prokurorët. Llojet e dënimeve të dhënë ndaj të miturve kanë qënë kryesisht dënim me burg (138), gjobë (35), gjobë dhe burgim (9) si dhe zbatimi i pezullimit me kusht të ekzekutimit të vendimit (82).
7. Shumicës të të miturve iu është dhënë dënimi nga 6 – 10 muaj burg (49 të mitur), ndërsa rreth 8 të mitur iu është dhënë 1 – 2 muaj burg, por ka dhe nga ato gjykata të cilat kanë zbatuar dënime mjaft të rënda

për të miturit si masa dënimit nga 3 – 5 vjet ose dhe masa denimi 6 – 10 vjet. Gjatë studimi këto masa dënimi të ashpra për të miturit janë dhënë nga gjykata e Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës.

8. *Ndonëse ligji parashikon përjashtimin e të miturit nga dënimi ose uljen e dënimit nën minimum e caktuar nga gjykata, dispozita të tilla nuk kanë gjetur zbatim. Gjithashtu, masat alternative ndaj të miturve nuk kanë qënë shumë të përdorshme. Kjo gjëndje është rrjedhojë e mungesës të strukturave mbikqyrëse për zbatimin e masave alternative, sesa i mungesës së dëshirës ose mosnjohjes së kësaj mundësie nga gjyqtarët. Ndër gjykatat që kanë aplikuar më shumë dhënien e masave alternative janë gjykata e Tiranës, Shkodrës, Vlorës. Më pak të aplikuara kanë qënë masat alternative në gjykatat e rretheve gjyqësore Fier, Elbasan, Gjirokastrë dhe Korçë.*

9. *Gjatë muajit tetor 2006 janë monitoruar edhe 18 seanca gjyqësore me të mitur në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë. Gjatë këtij muaji nga kjo gjykatë janë dhënë vetëm 2 vendime gjyqësore; shumica e seancave janë shtyrë disa herë për shkak të mosparaqitjes së të pandehurve, të prokurorit, të dëshmitarëve, të mosparaqitja e avokatëve. Seancat nuk kanë solemnitet (vetëm 3 seanca janë zhvilluar në salla e caktuara). Etika e gjyqtarëve ka qënë e mirë si ndaj të miturve dhe palëve të tjera në proces.*

10. Jo gjithnjë bëhet kujdes që vendimet e formës së prerë të dhënë nga gjykata e rretheve gjyqësore të vëzhguara të përmbajnë të gjitha të dhënat për të miturin (gjinia, arsimi, vendbanim gjënda gjyqësore, etj). Pothuajse në të gjitha vendimet nuk përcaktohen nëse gjykata kryhen verifikimet për personalitetin e të miturit.

Bazuar sa më lart, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i sugjeron institucioneve përkatëse të marrat masat e nevojshme që drejtësia shqiptare për të mitur të vendosë në vemendje të saj “Interesin më të lart të fëmijës”, parim i cili udhëheq dhe legjislacionin shqiptar dhe atë të huaj.

Për këtë KShH-ja sygjeron marrjen e masave të mëposhtme:

- *Ministria e Drejtësisë t'i sygjerojë Presidentit të RSH-së ngritjen e seksioneve të të miturve në gjykatat e mëdha sidomos në atë të Tiranës, të përbërë nga gjyqtarë të specializuar në drejtësinë e të miturve.*
- *I sygjerojmë kryetarëve të gjykatave të mos zbatojnë të drejtën që i jep ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh” për të lëvizur gjyqtarët nga një seksion në tjetrin, kur bëhet fjalë për gjyqtarët e të miturve.*
- *Në caktimin e gjyqtarëve të të miturve, të tregohet kujdes për caktimin e gjyqtarëve femra, me qëllim që të krijohen lehtësira në pyetjen e të miturve në çështje delikate.*
- *Më shumë kujdes i duhet kushtuar hartimit të vendimeve gjyqësore duke synuar përmirësimin e arsytimit të tyre dhe argumentin e tyre sipas standartave ndërkombëtare dhe praktikës së Gjykatës Europiane. Në këtë drejtim, KShH-ja vlerëson trajnimin vazhdues të gjyqtarëve, prokurorëve, të oficerëve të policisë gjyqësore për çështjet për të miturit të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës me asistentën e donatorëve të ndryshëm në Shqipëri dhe sygjeron që trajnime të tilla të vazhdojë duke vënë theksin në zbatimin më të mirë në praktikë të kërkesave të ligjit lidhur me drejtësinë e të miturve.*
- *KShH-ja përsëritet nismën e marrë për ndryshimet në kodin penal dhe i kërkon Ministrisë së Drejtësisë të përshpejtojë këtë reformë të nisur prej disa vitesh.*
- *Bazuar në kushtet në të cilat ndodhen vendet e paraburgimit dhe burgjet në Shqipëri dhe dëmet që mund të shkaktojë arrestimi dhe burgosja e të miturve, do të ishte e dobishme që gjykata të mbajë parasysh faktin se paraburgimi i të miturve të jetë një masë e jashtëzakonshme dhe nëse është i domosdoshëm, periudha e paraburgimit të jetë sa më e shkurtër.*

- *Gjykatat duhet të bëjnë më shumë kujdes lidhur me zhvillimin e seancave gjyqësore. Shtytjet e seancave gjyqësore në përgjithësi dhe për të miturit në veçanti çenojnë rëndë besimin e publikut te drejtësia por edhe shkelin rëndë të drejtat e shtetasve në proces.*
- *KShH-ja vlerëson politikën penale të zbatuar nga shumë gjyqtarë lidhur me zbatimin e masave alternative për të miturit, por nga ana tjetër i sugjeron Qeverisë shqiptare të investojë në ngritjen e qendrave sociale për trajtimin e fëmijëve dhe në hapjen sa më shpejt të shkollës së edukimit të të miturve.*
- *Në kushtet kur mungojnë qendrat e trajtimit të të miturve në konflikt me ligjin, KShH-ja i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë që në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve dhe Çështjeve Sociale të identifikojë shërbimet sociale private që funksionojnë në Shqipëri dhe të gjejë modalitetet e bashkëpunimit me to për trajtimin e fëmijëve.*
- *KShH-ja i kërkon Dhomës Kombëtare të Avokatisë, të organizojë trajnime të avokatëve që përfaqësojnë të miturit në proces dhe të gjejë mekanizma që mundësojnë ofrimin e shërbimeve ligjore falas nga avokatë të kualifikuar.*
- *KShH-ja vlerëson shërbimet ligjore dhe sociale të ofruara nga organizata të shoqërisë civile dhe i sugjeron Qeverisë Shqiptare të mbështesë shërbimet e tyre jo vetëm moralisht, por edhe financiarisht.*

Monitorimi i vendimeve gjyqësore dhe organizimi i kësaj tryeze u mundësuan falë mbështetjes së dhënë nga Fondacioni SOROS në Tiranë dhe CORDAID.